



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2017/2018

## TESTI

# MATEMATIKË

### UDHËZIME PËR PUNË

- Testin të cilin duhet të zgjidhësh i ka **20 detyra**. Për zgjidhjen e detyrave janë paraparë **120 minuta**.
- Detyrat nuk domethënë se duhet t'i zgjidhësh sipas radhitjes që janë dhënë.
- Ki kujdes se detyrat dallohen sipas mënyrës se si duhet të japësh përgjigje, (duke e plotësuar përgjigjen, duke e rrethuar, duke e bashkuar dhe duke e nënvizuar e të tjera).
- Gjatë punës mund të përdorësh lapsin e thjeshtë, gomën, vizoren, trekëndëshin dhe kompasin, por jo edhe kalkulatorin.
- Përgjigjet definitive dhe procedurën shkruaje me **stilolaps**.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet, si edhe përgjigjja të cilës i është hequr vizë.
- Mos shkruaj asgjë në këtë dhe në faqen e fundit, as në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës.
- Nëse e mbaron më herët zgjidhjen e testit, dorëzoje testin dhe largohu ngadalë duke pasur kujdes për qetësi.


**Ju dëshirojmë sukses në test!**

1. Një parkun nacional, në vitin 2016 ka pasur tridhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë vizitorë. Si shkruhet me shifra ky numër?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 3 317 000  
 b) 33 170  
 c) 33 107  
 d) 333 170


2. Plotëso fotografinë me numra të cilët mungojnë, ashtu që të gjitha operacionet e kryera të jenë të sakta.




3. Në grafikon është paraqitur vartësia e çmimit të akullores ( $y$ ) nga numri i topave të blerë ( $x$ ).

Plotëso fjalitë ashtu që të jenë të sakta.

- a) Dy topa akullore kushtojnë \_\_\_\_\_ dinarë.  
 b) Për 270 dinarë mund të blehen \_\_\_\_\_ topa akullore.  
 c) Katër topa akullore kushtojnë \_\_\_\_\_ dinarë.




4. Bëje lidhjen e dy monomeve prodhimi i të cilit është i barabart  $x^{12}y^4$ .

$x^2 y^2$	$x^2 y^4$	
$x^{10} y^4$	$x^{10} y^2$	
	$x^4 y^2$	


5. Gëzimi planifikon të bëjë me beton një shteg në formë kënddrejti me gjatësi 5,5 m dhe gjërësi 2 m dhe pranë shtegut një plakë në formë të katrorit me brinjë 4 m. Sa do të jetë sipërfaqja e përgjithshme me beton?

Rretho shkronjën para përgjigjes të saktë.

- a) 23,5 m<sup>2</sup>  
 b) 24 m<sup>2</sup>  
 c) 27 m<sup>2</sup>  
 d) 31 m<sup>2</sup>  
 e) 44 m<sup>2</sup>



6. Tangrami është vendosja e përshtatshmërisë së figurave matematikore më e njohur, e cila përbëhet nga shtatë figura. Në mesin e atyre figurave janë dy çifte figurash kongruente. Shkruaj çiftet e figurave kongruente ashtu që të shkruash në vizat e dhëna numrat që gjenden tek ato figura.




Një çiftë i figurave kongruente është \_\_\_\_ dhe \_\_\_\_, kurse çifti tjetër është \_\_\_\_ dhe \_\_\_\_.



7. Autobusi gjatë ditës bënë gjashtë nisje nga stacioni. Intervali kohor ndërmjet dy nisjeve të një pasë njëshme është i njëjtë. Plotëso tabelën ashtu siç është filluar.

Nisja e parë	Nisja e dytë	Nisja e tretë	Nisja e katërt	Nisja e pestë	Nisja e gjashtë
9 : 50	12 : 10	14 : 30			

8. Eliza, Erjona, Yllza dhe Argjenda kanë marrë pjesë në gara të gjuhës angleze, të cilat përbëhen nga pjesa me shkrim dhe pjesa me gojë. Rezultatet e tyre janë paraqitur në grafikun.




a) Kush ka pasur më së shumti pikë në pjesën me shkrim? \_\_\_\_\_

b) Kush ka pasur më së shumti pikë në pjesën me gojë? \_\_\_\_\_

c) Kush ka pasur më së shumti pikë në gara? \_\_\_\_\_

9. Në fotografi është paraqitur sa kohë nxënësi i kushton gjatë ditës (24 h): qëndrimin në shkollë (25%), mësimin (10%), aktiviteteve sportive (15%) dhe aktiviteteve tjera (20%).



- a) Sa kohë, e shprehur në përqindje, e kalon në gjumë?

Në gjumë e kalon \_\_\_\_\_ % të ditës.

- b) Sa orë nxënësi i kalon në shkollë?

Nxënësi në shkollë i kalonë \_\_\_\_\_ orë.



10. Rretho numrin poshtë drejtëzës numerike në të cilën janë pikat  $A(-\frac{5}{4})$ ,  $B(-1,45)$  dhe  $C(-1\frac{4}{5})$  të paraqitura në renditjen e rregullt.



1)



2)



3)



4)



5)



6)



- 11.** Simbolet ♥ dhe ♦ zëvendëso me shifrat nga bashkësia  $A = \{0, 1, 2, 3, 4, 5\}$ , ashtu që numrat e formës  $65♥2♦$  të jenë të pjesëtueshëm edhe me 2 dhe me 9. Cilët janë ata numra?

Ata numra janë \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_.

- 12.** Njehso vlerën e shprehjes.

Trego ecurinë.


$$\sqrt{169 - 25} \cdot \sqrt{\frac{(-3)^2}{16}}$$

Vlera e shprehjes është: \_\_\_\_\_.

- 13.** Flamuri Shtetëror i Republikës të Sërbisë është në formë të drejtëkëndëshit. Raporti i gjatësisë dhe gjerësisë është të flamurit është  $3 : 2$ . Nëse gjatësia e flamurit është 1,8 m, sa është gjërsia e flamurit? Trego ecurinë.

Gjërsia e flamurit është \_\_\_\_\_ m.


- 14.** Duke shfrytëzuar të dhënat nga fotografia, njehso vlerën e këndit  $\alpha$ .  
Trego ecurinë.



$$\alpha = \underline{\hspace{2cm}}$$



- 15.** Lapsi për të shkruar përbëhet nga maja e cila ka formën e konit dhe trupit që ka formën e cilindrit.




- Cakto vëllimin e lapsit të paraqitur në fotografi.  
Trego ecurinë.

$$\text{Vëllimi i lapsit është } \underline{\hspace{2cm}} \text{ mm}^3.$$



- 16.** Në sistemin koordinativ është dhënë trekëndëshi  $ABC$ . Cakto koordinatat e pikës  $A_1$  simetrike me pikën  $A$  në krahasim me origjinën koordinative, koordinatat e pikës  $B_1$  simetrike me pikën  $B$  në raport me boshtin  $y$  dhe koordinatat e pikës  $C_1$  simetrike me pikën  $C$  në raport me boshtin  $x$ .



$A_1$  (\_\_\_\_, \_\_\_\_);  $B_1$  (\_\_\_\_, \_\_\_\_);  $C_1$  (\_\_\_\_, \_\_\_\_)



- 17.** Njehso  $\sqrt{(1-A)^2}$ , nëse është  $A = \frac{\frac{1}{4} \cdot 0,35 + 1 \frac{1}{4} \cdot 0,25}{2-1,5} : \frac{1}{5}$ .  
Trego ecurinë.


$A =$  \_\_\_\_\_

$\sqrt{(1-A)^2} =$  \_\_\_\_\_





- 18.** Në trapezin barakrahësh është brendashkruar rrethi me rreze  $2\sqrt{3}$  cm. Këndi i ngushtë në bazë është  $60^\circ$ , kurse baza e gjatë është 3 herë më e gjatë nga baza e shkurtër. Njehso perimetrin dhe sipërfaqen e trapezit.  
Trego ecurinë.




$$P = \text{_____ cm}$$

$$S = \text{_____ cm}^2$$



- 19.** Trupi në fotografi është përbërë nga katër kube të barabarta. Vëllimi i trupit është  $1\frac{5}{27}$  dm<sup>3</sup>. Njehso sipërfaqen e trupit.  
Trego ecurinë.



$$S = \text{_____ dm}^2$$



- 20.** Ari i bardhë është legura në të cilën ka 75% ari, 15% argjend dhe 10% platinë. Çmimi i një unce të arit është 720 dollar, një uncë e argjendit është 30 dollar, kurse e platinës 2 400 dollar. Në Artari llogarisin se një uncë ka 30 gram. Përfitimi i Artarisë është 20% nga vlera e materialit nga e cila është punuar unaza. Çmimi i unazës formohet ashtu se në vlerën e materialit shtohet fitimi i Artarit. Sa është çmimi i unazës me masë 4 g?  
Trego ecurinë.

Çmimi i unazës me masë 4 g është \_\_\_\_\_ dollar.

